

## AKT THEMELIMI

### SHOQËRISË TREGTARE “ SARANDA 2024 ” SH.P.K.

Sot, më datë **11/11/2024** (dymijë e njëzetë e katër), mbështetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Shoqëri të Tregtare dhe të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007” Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëria Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortaket:

- Znj. **Klarida Semanjaku**, atësia Jani, amësia Gjenë, shtetase Shqiptare, lindur në Zharrez, Fier dhe banuese në PATOS, me adresë Demokracia 01690021; Nd. 87/1; H. 2; Zharëz; Sheqishtë; 9317; Patos, lindur më 30/01/1974, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtese e Leternjoftimit ID nr. 034562626 dhe nr. personal H45130017H, .
- Znj. **Denisa Bushi**, atësia Brahim, amësia Pashako, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në Fier, me adresë Afrim i Ri, Fier, Rr. Fier- Seman, kilometri i parë, godina private 13/147, lindur më 23/03/1993, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtese e pasaportes biometrike nr. BI0971608 dhe nr. personal J35323070L.

#### Formulimi

##### Neni 1

Formohet shoqëria Tregtare private e quajtur “ **SARANDA 2024** ” sh.p.k

Shoqëria do të nënshtrohet legjisllacionit shqiptar. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaket themelues.

##### Neni 2

##### Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë tregtare private “ **SARANDA 2024** ” sh.p.k do të ketë selinë e saj, Z.k 8642, pasuria nr. 8/261, Sarandë.

Shoqëria mund ta ndryshojë selinë e saj, të hap zyra perfaqësie, dege sa herë që vendos asambleja dhe ortaket.

### Neni 3

#### Objekti i Veprimtarise

Shoqëria ka për objekt veprimtarie :

“Veprimtari private në fushën e ndërtimit, të projektimit dhe zbatimit, ndërtime civile e ekonomike shumkateshe punime restaurimi, punime karpenterie, punime armature, murature, suvatim, nivelim shtresash, shtrime pllakash hidroizolimi, punime hidraulike, elektrike, veshje fasadash, ndërtime civile, industrial, etj në fushën e ndërtimit.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës”.

### Neni 4

#### Kohezgjatja e Shoqërise

Kohezgjatja e shoqërise do të jetë me një afat të pakufizuar. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

### Neni 5

#### Kapitali Shoqërise

Kapitali fillestar i shoqërise private “SARANDA 2024” SH.P.K. do të jetë 1,000 (një mijë leke). Kapitali është 50% dhe 50% nga kuotat e ortakëve e ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar).

### Neni 6

#### Drejtimi shoqërise

- **Administratori i shoqërise do të jetë Klarida Semanjaku.**
- Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërise i cili do ushtrojë detyrat e tij në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- Administratori si përfaqësues i paleve do të realizojë çdo lloj veprimtarie vetëm duke shprehur dakortësinë e ortakëve pra vetëm me 50+1 % të kuotave të arritura në marrëveshje në lidhje me të gjithë veprimtarinë e shoqërise.

**Shoqeria do te funksionoj ne baze te ketyre parimeve:**

1. Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesues i Shoqerise ne mardhenie me te trete.
2. Cdo vendimmarrje e shoqerise do te realizohet vetem me miratimin e te dy ortakeve te shoqerise, pra me artitjen e e 50+1 % te kuotave.
3. Ortaket e shoqerise do te vendosin vetem bashkerisht dhe jo me vete ne lidhje me sa me poshte vijon:
  - a. Nenshkrimin e cdo lloj dokumentacioni, akt-marreveshje, kontrata paraprake, cdo lloj kontrate te parashikuar nga kodi civil dhe legjislacioni shqiptar ne funksion te veprimtarise.
  - b. Hapjen e llogarise bankare ne emer te shoqerise prane njeres prej bankave te nivelit te dyte te Republikes se Shqiperise, llogari ne te cilen do te kene akses te dy ortaket dhe ne lidhje me sa me siper asnjeri prej tyre nuk mund te realizoj i vetem asnje transakcion, pagese, xhirim apo terheqje pa qene prezent edhe pala tjetere.
  - c. Perzgjedhjen e grupeve te punes dhe lidhjen e kontratave me ta.
  - d. Percaktimin dhe dhenien e ofertave.
  - e. Nenshkrimin e marreveshjeve me pale te treta ne rast se do te lind nevoja e dhenies se apartamenteve me klering.
  - f. Ortaket bien dakort qe secili prej tyre do tem und te investoj ne para fizike dhe ne aftesi intelektuale, qe do te thote secili prej ortakeve tregohet gatshem dhe jep miratimin qe ortaku tjetere te mund te :
    - ai) Te gjej persona kontakti
    - bi) Te ndihmoj ne pregatitjen e dokumentacioneve perkatese
    - ci) Te perdor aftesite e tij intelektuale ne lidhje me hartimin e kontratave referuar bazes se rregullt ligjore ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne Fuqi.
    - di) Te gjej alternativa dhe mundesi te mira per zhvillim nga shoqeria si troje, apo objekte me qellim zhvillimin e ketyre pronave ne favor te shoqerise.
    - fi) Referuar sa me siper I njihet kontributi ne kompensim financiar ortakut qe ofron ndihmen juridike ne baze te aftesive intelektuale referuar neneve 3 f deri ne (fi).
4. Cmimi i shitjes do te vendoset me miratim te perbashket te ortakeve te shoqerise.
5. Percaktimi i pagesave te grupeve te punes do te realizohet me miratim te perbashket te ortakeve te shoqerise.
6. Secili nga ortaket e shoqerise ka te drejte qe te bej kontrole te vazhdueshme ne kantier , te kontrolloje punimet dhe ne rast se sheh parregullsi te njoftoj ortakun tjetere per sistemimin e situates.

**Neni 7**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve te shoqerise ne maswn 50% per secilin ortak. Shoqeria ne perfunsimte shitjeve do te mbledhi te ardhurat dhe pasi te pagohet dividenti vlere e mbetur e grumbulluar nga shitjet do te ndahet ne menyre te barabarte 50% me 50% mids ortakeve te shoqerise.

### Neni 8

Shoqeria do te kete vulen e saje me madhesi te zkonshme, me logon dhe tekstin brenda saj, ne momentin e rregjistrimit te shoqerise .

### Neni 9

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptare ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe regullave qe zbatohet per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

Ceshtje qe nuk trajtohen ne kete akt themelimi, rregullohen ne Statutin e Shoqerise si dhe ne legjislacionin perkates shqiptar.

### Neni 10

#### Zgjidhja e mosmarreshjeve

Palet duhet te zgjidhin cdo konflikt me mirekuprim dhe marreshje midis tyre, ne te kundert i drejtohen gjykates kompetente te rrethit gjyqesor.

Akti i themelimit u perpilua ne 5 kopje, per tju shperndare organeve kopetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "SARANDA 2024" sh.p.k.

Akti i themelimit u nenshkrua rregullisht nga ortaket e shoqerise.

Ortaku i shoqerise

Klarida Semanjaku

*Klarida Semanjaku*



Ortaku i shoqerise

Denisa Bushi

*Denisa Bushi*

